# DËSHMI ARKIVI

**A-441350**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pagat e magjistratëve, reagon Gjykata Kushtetuese: Kuvendi të zbatojë vendimin tonë! |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/07/pagat-e-magjistrateve-reagon-gjykata-kushtetuese-kuvendi-te-zbatoje-vendimin-tone/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 19:43:50 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 7 shtator 2026, 11:51:47 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a92b44e92472ee13010f73f7d8325bb7c40af6039d6a4535c3a6acdd9a4d35c2` |
| TEKSTI | `3ef6b4a2f29f72ff9652a99c5b56460fe94d9df7086fbeed6fe3cd83857e1cc1` |
| PAMJA | `cde065ac03907fc3ffbc8c3f95f675a6b6bff3bad977748303e0c54bd6007640` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `dd497b9aaaa9acb8fc81f3c91c891bfb644c2cd6f1e576e8acf10d61b879c571` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/dd497b9aaaa9acb8fc81f3c91c891bfb644c2cd6f1e576e8acf10d61b879c571`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Pagat e magjistratëve, reagon Gjykata Kushtetuese: Kuvendi të zbatojë vendimin tonë!

Aktualitet

Publikuar: 07/09/2026




Gjykata Kushtetuese ka reaguar lidhur me diskutimet publike për pagat e magjistratëve dhe mënyrën e zbatimit të vendimit të saj, të publikuar në 17 shkurt të këtij viti.

Në një deklaratë për mediat, Gjykata thekson se për këtë çështje është shprehur tashmë përmes vendimit të saj. Sipas saj, vendimi përcakton standardin kushtetues që duhet të zbatohet, si dhe detyrimet që burojnë prej tij për autoritetet përgjegjëse.

Kushtetuesja nënvizon se arsyetimi dhe dispozitivi i vendimit përbëjnë qëndrimin zyrtar dhe duhet të lexohen e të zbatohen në tërësinë e tyre. Ajo rikujton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim nga autoritetet përkatëse. Respektimi i tyre, sipas Gjykatës, është kërkesë e drejtpërdrejtë e rendit kushtetues dhe lidhet ngushtë me parimin e shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike.

GJK sqaron gjithashtu se mënyra e përllogaritjes dhe ekzekutimit të pagave në administrimin e saj të brendshëm, në varësi të fondeve buxhetore, nuk përcakton efektet juridike të vendimit. Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese thekson se zbatimi i vendimit nr. 15 duhet të bëhet në përputhje me standardet dhe detyrimet kushtetuese të përcaktuara prej saj.

**Reagimi i Gjykatës Kushtetuese**

*Në lidhje me diskutimet publike për çështjen e pagave të magjistratëve, Gjykata Kushtetuese vlerëson të nevojshme të sqarojë se për këtë çështje është shprehur tashmë me vendimin nr. 15, datë 17.02.2026*

*Përmes këtij vendimi, Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar standardin kushtetues të zbatueshëm, duke evidentuar*

Me të lexuarat


Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e fundit, Spahi...


Benet Beci i dha tender Besnik Leskajt pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet në administrat...


I tmerrshmi i Beratit / Si ra Lulzim Caka në prangat e policisë greke për trafik kokaine, saga e ...


Porcelli padit Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë biznesmenit izrae...


Emri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

*njëkohësisht detyrimet që burojnë prej tij për autoritetet përgjegjëse. Arsyetimi dhe dispozitivi i vendimit përbëjnë qëndrimin zyrtar të Gjykatës për çështjen e shqyrtuar dhe, për rrjedhojë ato duhet të lexohen e të zbatohen në tërësinë e tyre, në përputhje me parimet kushtetuese të përcaktuara në të.*

*Gjykata rithekson se vendimet e saj janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Respektimi dhe zbatimi i tyre përbën një kërkesë të drejtpërdrejtë të rendit kushtetues dhe është i lidhur ngushtësisht me parimin e shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike.*

*Në këtë kuptim, Gjykata sqaron se mënyra e përllogaritjes dhe e ekzekutimit të pagave në administrimin e brendshëm të saj, në varësi të fondeve buxhetore në dispozicion, nuk mund të interpretohet si përcaktuese për efektet juridike të vendimit nr. 15, datë 17.02.2026 dhe as për detyrimet që ky vendim sjell për autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tij.*

TAG: Gjykata kushtetuese


## Të ngjashme



**Nafta shtrenjtohet në Shqipëri, fqinjët mbajnë çmimet të pandryshuara! Braçe kërkon shpjegime, ngre pikëpyetje për tregun e karburanteve**



**Çmimi i naftës tjetër rekord, po shitet me 229 lekë litri / A do të rikthehet Bordi i Transparencës?**



**Zbardhet raporti i Von der Leyen, vlerëson Shqipërinë për mbylljen e tre kapitujve të parë negociues**



## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.



## Kategoritë

KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË
KRYESORE POLITIKË EKONOMI
ANALIZË RAJON KULTURË SPORT


Email: [email protected]
Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena
Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.